



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Qytetari

Varianti B

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	5	6	8	9	12	14	17	20
Përgjigja e saktë	D	A	B	D	C	D	C	B	B	C

• *Pyetjet me zhvillim*

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë te tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin

1. D) të gjitha alternativat
2. A) **fizik, mendor, emocional, social dhe shpirtëror**
3. Model përgjigjeje:

Ligji parandalon:

- a) dëmtimin e shëndetit fizik/ psikologjik/ emocional / mendor;
- b) përfshirjen e fëmijëve në rrjetet e krimit;
- c) përfshirjen e fëmijëve në grupin e përdoruesve të këtyre lëndëve;
- d) shfrytëzimin e punës së tyre;
- e) abuzimin me moshën e tyre nga kriminelët e rritur;
- f) ndikimin negativ tek bashkëmoshatarët në shkolla/ komunitet etj.

3 pikë Nëse shkruan tre rreziqe që parandalon ligji për mbrojtjen e shëndetit, i cili ndalon shpërndarjen dhe tregtimin e substancave narkotike.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy rreziqe që parandalon ligji për mbrojtjen e shëndetit

1 pikë Nëse shkruan një rrezik që parandalon ligji për mbrojtjen e shëndetit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

4. Model përgjigjeje:

Ushqimet OMGJ:

- Dëmtojnë aparatit tretës;

- Krijojnë alergji;
- Shkaktojnë kancer;
- Dëmtojnë biodiversitetin;
- Shkaktojnë dëme ekonomike tek fermerët;
- Cënojnë marrëveshjet e Tregtisë së Lirë me vendet e Bashkimit Evropian.

3 pikë Nëse shkruan tre nga dëmet e ushqimeve të modifikuara gjenetikiisht.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga dëmet e ushqimeve të modifikuara gjenetikiisht

1 pikë Nëse shkruan një nga dëmet e ushqimeve të modifikuara gjenetikiisht

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

5. B) dëmtimin e shikimit

6. D) firmosja në praninë e noterit

7. Model përgjigjeje:

- a) të mos mbajë një pasagjer në biçikletë;
- b) të mos qendrojë afër një mjete në lëvizje;
- c) të mos varet pas një mjete motorik në lëvizje;
- d) të mos përdorë korsinë e gabuar;
- e) të mos ngasë biçikletën në mënyrë të rrezikshme;
- f) të mos ngasë biçikletën nën efektin e alkoolit dhe drogës etj.

3 pikë Nëse shkruan tri këshilla që një çiklist duhet të bëjë për sigurinë vetjake.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy këshilla që një çiklist duhet të bëjë për sigurinë vetjake

1 pikë Nëse shkruan një këshillë që një çiklist duhet të bëjë për sigurinë vetjake

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

8. C) vertikale, horizontale, të shndritshme dhe pajisjet shtesë.

9. D) Publikimi dhe trajtimi i dukurisë së përdhunimit.

10. Model përgjigjeje:

- a) informimi pa emocione;
- b) informimi konkret;
- c) përdorimi i citimeve;
- d) referimi i të gjitha burimeve;
- e) i paanshëm;
- f) informimi real;
- g) i depolitizuar etj.

3 pikë Nëse shkruan tri rregulla që përbëjnë Kodin Etik të gazetarit.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy rregulla që përbëjnë Kodin Etik të gazetarit.

1 pikë Nëse shkruan një rregull që përbën Kodin Etik të gazetarit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

11. Tregoni tre pasoja që vijnë nga moszbatimi i ligjit.

Model përgjigjeje:

- a) dënim me burgim: mbron shoqërinë, e disiplinon të burgosurin, ndëshkim si lloj drejtësie dhëmb për dhëmbë, që shmang hakmarrjen, rehabilitim, drejtësia kurative- ai kthehet te mjedisi i tij pas kurimit, çlirimi- i lidhur me rehabilitimin;
- b) dënim me gjobë-konfiskim i pasurisë, i mjeteve të përdorura për kryerjen e krimit;
- c) ndalimi i të drejtës për të drejtuar automjeti;
- d) ndalim i të drejtës për të ushtruar detyra apo profesione të caktuara;
- e) heqja e titujve dhe dekoratave;
- f) përgjegjësi: penale- burgim, gjoba penale; civile- kamata apo deri në ndërprerje të energjisë elektrike apo ujit, në rast mospagimi të faturave të tyre; dhe administrative etj.

3 pikë Nëse shkruan tre nga pasojat e moszbatimit të ligjit

OSE

- 2 pikë** Nëse shkruan dy nga pasojat e moszbatimit të ligjit
1 pikë Nëse shkruan një nga pasojat e moszbatimit të ligjit
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

12. **C) kushtetutshmërisë**

13. Model përgjigjeje

- a) ndarja e pushteteve
 b) sovranitetit
 c) zgjedhjet e lira

3 pikë Nëse shkruan tre parimet e sakta sipas sipas përkatësisë në kërkesë të ndara në a, b, c

OSE

- 2 pikë** Nëse shkruan saktë dy nga parimet e kushtetutës sipas përkatësisë në kërkesë
1 pikë Nëse shkruan një nga parimet e kushtetutës sipas përkatësisë në kërkesë
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

14. **B) ekonomik**

15. Model përgjigjeje:

- koeficient i përgjithshëm i lindshmërisë;
- koeficient i përgjithshëm i vdekshmërisë;
- koeficient i përgjithshëm i vdekshmërisë foshnjore;
- shtesa natyrore e popullsisë;
- norma e migrimit të popullsisë, etj.
- lëvizja mekanike e popullsisë: migrimi-emigrimi (faktorë shtytës-tërheqës/lëvizje hyrëse-dalëse/norma neto e migrimit); procesi i urbanizimit, etj.

3 pikë Nëse shkruan tre nga treguesit e zhvillimit demografik të popullsisë

OSE

- 2 pikë** Nëse shkruan dy nga treguesit e zhvillimit demografik të popullsisë
1 pikë Nëse shkruan një nga treguesit e zhvillimit demografik të popullsisë
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

16. Model përgjigjeje:

- koeficienti i shkollës
- koeficienti i lëndëve me zgjedhje
- notat e provimeve të detyruara
- notat e provimeve me zgjedhje
- mesatarja e shkollës së mesme;
- përqindja e mesatares së shkollës së mesme;
- përqindja e notave të provimeve të Maturës, etj.

3 pikë Nëse shkruan tre elemente që ndikojnë në pranimin në shkollat e larta me sistemin meritë-preferencë

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy elemente që ndikojnë në pranimin në shkollat e larta me sistemin meritë-preferencë

1 pikë Nëse shkruan një element që ndikojnë në pranimin në shkollat e larta me sistemin meritë-preferencë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

17. **B) përgjegjësi penale**

18.

. Model përgjigjeje:

Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve:

Të drejtat e përmedura në këtë Konventë i garantohen çdo fëmije, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

a) Detyrimet e prindërve:

- të konsiderojnë parësore interesat e fëmijëve.
- interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.
- të sigurojë të ardhura për kushte normale jetese.
- të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.
- mirërritja fizike, shëndetsore mendore, psikologjike, emocionale
- fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me fëmijët e lindur nga martesë

- fëmijët e birësuar kanë të drejta të barabarta si fëmijët e tjerë;
 - nëse ndaj fëmijëve ushtrohet dhunë fizike dhe psikologjike, shteti ka të drejtë të ndërhyjë në jetën private të familjes për të mbrojtur fëmijën;
 - arsimimin e fëmijëve në nivelin e detyrimit nga ligji, etj.,
- b) Ligji garanton që fëmijët të marrin ndihmë shoqërore dhe mbrojtje nga shteti:
- ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë
 - ndihma ekonomike për familjet në nevojë, për mirërritjen e fëmijëve të tyre;
 - shpërblimi financiar për fëmijët e lindur dhe lejet për gratë shtatëzëna;
 - mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
 - mbrojtjen dhe strehimin e fëmijëve të dhunuar/ të braktisur/jetimë;
 - fëmijët që kanë braktisur shkollën;
 - arsimimin e fëmijëve në nevojë(pa familje, me probleme familjare, romët dhe egjiptiane etj.);
 - që vuajnë nga gjakmarrja etj.
- c) raca

Ligji mbron dhe garanton të gjitha të drejtat e mishëruara në dokumentet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas pa dallime **racore**, gjinie, feje, kulture, moshe, etj., të drejtën e pamohueshme për të jetuar/garantimin e sigurisë/ shëndetit/dinjitetit /personalitetit/për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës/arsimimin, etj.

3 pikë Nëse shkruan tre elemente nga ligjet shqiptare për fëmijët sipas përkatësisë në kërkesë të ndara në a, b, c
OSE

2 pikë Nëse shkruan saktë dy elemente nga ligjet shqiptare për fëmijët sipas përkatësisë në kërkesë

1 pikë Nëse shkruan një elemente nga ligjet shqiptare për fëmijët sipas përkatësisë në kërkesë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

19. Model përgjigjeje:

Të rriturit dhe adoleshentët duhet:

- të jenë të sinqertë;
- të respektojnë njëri-tjetrin;
- të mirëkuptojnë njëri-tjetrin;
- palët të kenë besim te njëri-tjetri;
- të mos jenë kritikë dhe gjykues;
- të shmangin tensionimin e situatave për probleme të ndryshme;
- të mos paragjykojnë bindjet e njëri-tjetrit;
- të reagojnë duke përdorur emocione pozitive;
- të shprehin dhe kuptojnë ndjenjat e njëri-tjetrit etj.

3 pikë Nëse shkruan tre rrugë që mundësojnë zgjidhjen e kundërshtive ndërmjet të rriturve dhe adoleshentëve.

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy rrugë që mundësojnë zgjidhjen e kundërshtive ndërmjet të rriturve dhe adoleshentëve.

1 pikë Nëse shkruan një rrugë që mundësojnë zgjidhjen e kundërshtive ndërmjet të rriturve dhe adoleshentëve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

20. C) **dëmtimi i shëndetit të tyre**